

## **AKT - THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "HOTEL PRIMAVERA 2004" SH.P.K.**

Ne baze te ligjit Nr. 7512 dt. 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire , te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit " dhe ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " si dhe nenit 64 te ligjit Nr. 7667 dt. 28.01.1993 per regjistrimin e shoqerive ne Regjistrin Tregtar, me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenskrimin e ketij akti, ortaku i vetem :

**Z. Fatmir Brokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Sulejmanit, lindur me 05.08.1968 ne Vlore e banues ne Tirane, Lagjia "10 Korriku" Nr.51, Vlore, mbajtes i pasaportes 1793832, me detyre Administrator i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" SH.P.K.,

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. eshte :

"Bar-kafe, restorant, hoteleri, turizem, import - eksport, tregtimi me shumice e pakice te artikujve e mallrave te ndryshem ushqimore, industrial, konfeksione, tekstil, elektroshtepiake, bujqesore, blektorale, duralumini, paisje elektrike, elektronike, mobilje e paisje druri, materiale inerte dhe hidrosanitare, artikujve farmaceutike, kozmetike, sanitare , aksesore etj, dhe transportimi i tyre, Transportin me te gjitha llojet e mjeteve te mallrave e pasagjereve per llogari te vete shoqerise ose per te trete, ne fushen e sherbimit, krijimin e agjensive turistike."

### **SELIA E SHOQERISE**

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "HOTEL PRIMAVERA 2004" eshte ne qytetin e Vlores, "HOTEL PRIMAVERA 2004" L. "10 Korriku", prane Akademise se Marines Vlore.

Ajo gezon te drejten te krijoje ose te mbylle ne Shqiperi apo jashte saj filiale, perfaqesi apo seli te tjera.

## **JETEGJATESIA E SHOQERISE**

Jetegjatesia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. eshte mbi 10 vjet. Ortaku i vetem ka te drejte qe te nderprese kete kohezgjatje para afatit ose te kerkoje kohezgjatje para afatit ose te kerkoje rizgjatjen e saj prane Regjistrin Tregtar Tirane.

### **KAPITALI I SHOQERISE.**

Kapitali themeltar i Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. eshte 100.000 (njqind mije) leke. Aktiviteti financiar i shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti dhe bilanci duhet aprovuar brenda kater muajve te ardhshem.

Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit ne Rregjistrin Tregtar Tirane.

### **ORGANET E SHOQERISE**

- Vendim i Ortakut te Vetem.
- Administratori ose Drejtori i Pergjithshem.


Modifikimet e mundshme apo shtesa ne kete akt do te kene vlere dhe do te zbatohen vetem ne se autorizohen nga organet kompetente.

Marredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen me ane te kontrates se punes. Per çeshtje qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e " KODIT TE PUNES ". Kjo eshte e njejte edhe per filialet , zyrat e perfaqesimit apo agjensite.

**ORTAKU I VETEM**

**FATMIR BROKAJ**

FATMIR BROKAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 738 Rep.

Nr. \_\_\_ Kol.

## VERTETIM

Sot, me daten 01/03/2004 (dymije e kater) , para meje Noterit Sh. Dushaj, u paraqit personalisht ortaku :

**Z. Fatmir Brokaj**, shtetas shqiptar, i biri i Sulejmanit, lindur me 05.08.1968 ne Vlore e banues ne Vlore Lagjia "10 Korriku" Nr. 51, me pasaporte Nr. 1793832, me detyre Administrator i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" SH.P.K.,

i cili deklaroi se sa siper eshte akt themelimi per regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. me Seli ne Vlore , hartuar jashte kesaj Zyre noteriale me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenshkruan rregullisht para meje Noterit dhe une Noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER

# STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"HOTEL PRIMAVERA 2004" SH.P.K.

I ORTAKUT TE VETEM Z. FATMIR BROKAJ

## NENI 1

Shoqeria "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. eshte prone e pronarit Z. FATMIR BROKAJ, banues ne Vlore.

## NENI 2

Shoqeria "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. eshte Person Juridik shqiptare. Ajo fiton zotesi per te vepruar qe nga momenti i regjistrimit ne Gjykate.

## NENI 3

Shoqeria "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj.

## NENI 4

Shoqeria "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe kohe mbi 10 vjet. Ajo e ka qendren e saj ne Vlore.

## NENI 5

Kapitali fillestar i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. eshte 100 000 (njqind mije) leke.

## NENI 6

Objekti i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. do te jete:

"Bar-kafe, restorant, hoteleri, turizem, import - eksport, tregetimi me shumice e pakice te artikujve e mallrave te ndryshem ushqimore, industrial, konfeksione, tekstil, elektroshtepiake, bujqesore, blektorale, duralumini, paisje elektrike, elektronike, mobilje e paisje druri, materiale inerte dhe hidrosanitare, artikujve farmaceutike, kozmetike, sanitare , aksesore etj, dhe transportimi i tyre, Transportin me te gjitha llojet e mjeteve te mallrave e pasagjereve per llogari te

vete shoqerise ose per te trete, ne fushen e sherbimit, krijimin e agjensive turistike.”

#### **NENI 7**

Shoqeria “HOTEL PRIMAVERA 2004” sh.p.k. per detyrimet e rrjedhura ndaj personave te trete pergjigjet me fondet e veta.

#### **NENI 8**

Sipas kerkesave te legjislacionit te Republikes se Shqiperise, Shoqeria “HOTEL PRIMAVERA 2004” Sh.p.k. kapitalin themeltar do ta depozitoje ne Bankat e Shtetit shqiptar shteteror apo privat.

#### **NENI 9**

Personi pergjegjes per themelimin e Shoqerise “HOTEL PRIMAVERA 2004” sh.p.k. eshte administratori i saj Z. FATMIR BROKAJ.

### **MARRDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE.**

#### **NENI 1**

Veprimtaria e Shoqerise “HOTEL PRIMAVERA 2004” sh.p.k. realizohet ne perputhje me leverdine e saj ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin perkates.

#### **NENI 2**

Kapitali themeltar eshte burimi fillestar per krijimin e fondeve te veçanta e te fondeve te tjera te xhiros.

#### **NENI 3**

Shoqeria “HOTEL PRIMAVERA 2004” sh.p.k. mund te pushoje veprimtarine e saj pasi te kete shlyer detyrimet ndaj te treteve.

#### **NENI 4**

Shoqeria “HOTEL PRIMAVERA 2004” sh.p.k. nepermjet administratorit te saj ka ta drejten e disponimit , te gezimit e te perdorimit te pasurive te veta ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe ajo kryen. Ajo gezon te drejten e mbrojtjes se pasurive qe ajo ka ne perputhje me legjislacionin e Shqiperise ne fuqi.

#### **NENI 5**

Shoqeria me fondet rezerve dhe fondet e tjera te veçanta qe krijon ka te drejte te kryej lirisht çdo lloj veprimtarie ekonomike, tregtare, financiare me person juridik apo fizik, shqiptare apo te huaj.

## **NENI 6**

Shoqeria sipas mundesive qe mund t'i krijohen , ka te drejte qe te investoje nga kapitalet e veta ne ndermarrje e institucione.

## **NENI 7**

Fitimi neto i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. qe realizohet nga ushtrimi i veprimtarise private te saj, pasi konvertohet ne valute te huaj, sipas rregullave ne fuqi, mund te transferohet jashte shtetit pa asnje pengese.

## **NENI 8**

Pasuria e Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. pasqyrohet ne bilancin e saj me vlera te shprehura ne monedhen e Shqiperise ose te huaja, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Bilanci vjetor i vitit te pare te veprimtarise se Shoqerise paraqitet brenda Mars te vitit pasardhes, e keshtu veprohet çdo vit. Bilançi vjetor mbeshtetet ne raportin e paraqitur nga eksperti kontabel i ngarkuar nga administratori i saj.

## **NENI 9**

Veprimtaria financiare e Shoqerise mbeshtetet ne aktivet e pasivet qe detyrimisht pasqyrohen ne bilanc. Llogarite kontabile dhe ato ekonomike mbahen ne Shqiperi. Rezultatet ekonomike te Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. caktohen ne baze te te dhenave te bilancit vjetor.

## **NENI 10**

Shoqeria "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. paguan rregullisht ne afat te caktuar detyrimet fiskale ne baze te dispozitave ne fuqi.

## **NENI 11**

Shoqeria "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. ka te drejte qe per te shlyer detyrimet ndaj te treteve te lere peng pjese nga kapitali themeltar.

## **NENI 12**

Marrdheniet e punes me punetoret qe do te punesohen prane kesaj Shoqerie rregullohen me kontrate individuale qe do te lidhet me sejcilin punetor ne veçanti. Marrja ne pune e punonjesve do te behet nga vete punedhenesi (administratori), duke i regjistruar ne rregjistrin perkates dhe duke njoftuar dhe organet e punes te juridiksionit ku ushtron veprimtarine Shoqera "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k.

Shoqeria do te beje sigurimin e punonjesve prane organit te Sigurimeve Shoqerore, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### **NENI 13**

Paga e punetoreve caktohet ne kontraten qe lidh sejcili ne baze e ne perputhje me treguesit ekonomiko-financiar. Madhesia e shperblimit te punes eshte e pa kufizuar, por mund te jete ne raste te veçanta me e vogel nga ajo e percaktuar ne aktet e veçanta ligjore. Ne perputhje me kushtet konkrete, shperblimi per punen e kryer mund te jete orare, ditore, javore ose mujore.

## **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQERISE "HOTEL PRIMAVERA 2004" SH.P.K.**

### **NENI 1**

Drejtimi i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. behet nga administratori i saj. Ai vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet e statutit, per shtimin dhe pakesimin e kapitalit themeltar, per likuidimin e shumave suplementare ne kapitalin themeltar, per emerimin e eksperteve , likuidatoreve dhe per pushimin e veprimtarise se Shoqerise , si dhe ndryshimin e formes se saj.

### **NENI 2**

Administrator i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. do te jete z. FATMIR BROKAJ

### **NENI 3**

Administratori jo ortak ka per detyre :

- Te mireadministroje mallrat qe i jane besuar ne administrim.
- Te marre masa per sigurimin e mallrave sipas ligjeve ne fuqi dhe per ruajtjen e mallrave dhe te materialeve me roje te posaçme, pasi te merret pelqimi i administratorit.
- Administratori eshte pergjegjes para Ortakut te Vetem per mos kryerjen e detyrave qe percaktohen ne kontraten tip te lidhur mes tyre.
- Demi i ardhur per fajin e personave pergjegjes te materialeve apo likuidatorit sipas kontratave ata jane pergjegjes para administratorit te Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. materialisht.

### **NENI 4**

Vendimet qe merr administratori i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. vertetohen me proces-verbalin e nenshkruar prej tij si dhe nga avokati kur eshte i thirrur.

#### **NENI 5**

E drejta e Shoqerise dhe e perfaqesimit te saj i perket administratorit te Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. Ai mund te jape prokure te vecante ose te pergjithshme per ta perfaqesuar ne marredhenie me te trete e kedo qe çmon te arsyeshme.

### **RIORGANIZIMI DHE PUSHIMI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE "HOTEL PRIMAVERA 2004" SH.P.K.**

#### **NENI 1**

Riorganizimi i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. sipas kushteve te percaktuara me ligj, mund te behet me pelqimin e administratorit.

#### **NENI 2**

Veprimtaria e Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne dispozitat e mesiperme. Ajo mund te pushoje veprimtarine dhe kur Shoqeria nuk realizon me fitime.

#### **NENI 3**

Kur Shoqeria pushon veprimtarine e saj , atehere administratori cakton grup ekspertesh prej tre vetesh , te cilet pergatisin raportin kontabel dhe ja paraqesin per shqyrtim administratorit.

#### **NENI 4**

Ky statut eshte i vlefshem ne çastin e nenshkrimet te tij nga administratori i Shoqerise "HOTEL PRIMAVERA 2004" sh.p.k. Z. FATMIR BROKAJ.

### **ORTAKU I VETEM**

**ADMINISTRATORI**

**FATMIR BROKAJ**

FATMIR BROKAJ